



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 650/4 Prot.

Vlorë më, 11.03 2026

VENDIM

Nr. 12, datë 11.03.2026

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMITETEVE SHKENCORE TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22 dhe nenit 127, pika B, të Rregullores së Brendshme të UV-së; si dhe duke iu referuar shkresës nr.613, prot., datë 05.03.2026, të Drejtorisë së Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 11.03.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë, nen për nen dhe në tërësi, Rregulloren e Komiteteve Shkencore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor dhe Drejtoria e Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët.
3. Ky vendim u përcillet për njoftim njëjësive kryesore të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Administratorit të UV-së, Drejtorisë së Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akadematike, për shpallje në faqen web të vendimit dhe për realizimin e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

R R E G U L L O R E
E K O M I T E T E V E S H K E N C O R E
T Ë
U N I V E R S I T E T I T " I S M A I L Q E M A L I "
V L O R Ë



Miraturar nga Senati Akademik me Vendim nr. 12 datë 11.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

RREGULLORE

për

organizimin dhe funksionimin e

Komiteteve Shkencor të njësive kryesore të UV-së

PREAMBULË

Në përmbushje të misionit themelor të institucionit të arsimit të lartë për zhvillimin e kërkimit shkencor, rritjen e cilësisë akademike dhe forcimin e impaktit ndërkombëtar të prodhimit shkencor, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve normative institucionale, Senati Akademik miraton këtë Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Shkencor.

Kërkimi shkencor përbën një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë akademike dhe një instrument thelbësor për zhvillimin institucional, përmirësimin e programeve të studimit, fuqizimin e kapaciteteve kërkimore dhe rritjen e reputacionit akademik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, krijimi dhe funksionimi i një mekanizmi të strukturuar për shqyrtimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve kërkimore përbën domosdoshmëri institucionale.

Kjo Rregullore synon të garantojë:

- ☐ Transparencë dhe objektivitet në procesin e miratimit të projekteve;
- ☐ Zbatimin e standardeve të larta metodologjike dhe etike;
- ☐ Përputhshmërinë e veprimtarisë kërkimore me prioritetet strategjike të universitetit;
- ☐ Rritjen e performancës shkencore dhe të publikimeve të indeksuara ndërkombëtarisht;
- ☐ Përdorimin e përgjegjshëm dhe efikas të burimeve financiare dhe infrastrukturore.

Nëpërmjet kësaj Rregulloreje përcaktohen kompetencat, procedurat dhe mekanizmat e kontrollit që sigurojnë një sistem të qëndrueshëm dhe të matshëm të menaxhimit të kërkimit shkencor në nivel fakulteti dhe universiteti.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KREU I OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1 Qëllimi dhe Objektivat e Rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin, funksionimin, përbërjen, kompetencat dhe procedurat e punës së Komiteteve Shkencore në UV, të ngritura në nivel njësisht kryesore dhe/ose institucioni.

Objektivat e Rregullores:

1. Kjo Rregullore përcakton organizimin, funksionimin, kompetencat dhe procedurat e veprimtarisë së Komiteteve Shkencore të UV-së, si struktura akademike përgjegjëse për:
 - a) Shqyrtimin dhe miratimin e projekteve kërkimore të propozuara nga personeli akademik;
 - b) Monitorimin e zbatimit të projekteve;
 - c) Vlerësimin shkencor të raporteve përfundimtare;
 - d) Garantimin e cilësisë dhe integritetit në kërkimin shkencor;
 - e) Kontributin në realizimin e objektivave strategjike institucionale në fushën e kërkimit.
2. Kjo Rregullore synon të krijojë një mekanizëm të strukturuar, transparent dhe të matshëm për menaxhimin e veprimtarisë kërkimore në nivel fakulteti dhe universiteti.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në:

1. Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
2. Ligj nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to (ndryshuar me ligjin nr. 37/2022, datë 14.4.2022)"
3. Ligj nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"
4. Vendim nr.165, datë 21.3.2018 "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë"
5. Vendim nr. 777, datë 26.12.2018 "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"
6. Vendim nr. 99, datë 5.2.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të këshillit të ministrave, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"
7. Vendim nr.112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "profesor i asociuar" dhe "profesor" (ndryshuar me vkm nr. 808, datë 11.12.2019)"
8. Vendim nr. 607, datë 31.8.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit (AKKSHI)"
9. Statuti i UV-së.
10. Rregullore e Brendshme e UV-së (nenet 122-135, 127)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

11. Rregullore për PKZHUV
12. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2025–2030
13. Strategjia e Kërkimit Shkencor në UV 2026-2030.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet për:
 - a) Gjithë Komitetet Shkencore të ngritura në UV, në nivel institucional dhe njësisë kryesore.
 - b) Të gjithë anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë;
 - c) Grupet kërkimore të njësisë kryesore;
 - d) Projektet kërkimore të financuara nga universiteti, nga burime kombëtare ose ndërkombëtare, kur kërkohet miratim institucional.
2. Funksionimi i Komiteteve Shkencore bëhet i nevojshëm në rastet kur projektet:
 - a) Kërkojnë miratim formal institucional;
 - b) Përdorin infrastrukturën laboratorike të universitetit;
 - c) Angazhojnë fonde institucionale;
 - d) Parashikojnë publikime në emër të universitetit;
 - e) Kërkojnë vlerësim shkencor të raportit final të projektit për përmbajtjen shkencore dhe cilësinë e rezultateve të tij.

Neni 4 Përfshirjet

1. Kjo Rregullore nuk zbatohet për:
 - a) Aktivitetet individuale kërkimore që nuk kërkojnë miratim institucional;
 - b) Punimet akademike individuale që nuk angazhojnë fonde apo strukturë institucionale;
 - c) Projektet që menaxhohen drejtpërdrejt nga struktura qendrore e universitetit, nëse rregullohen nga akte të posaçme.
2. Në rast dyshimi mbi fushën e zbatimit, vendos Rektorati ose struktura përkatëse akademike / administrative.

Neni 5 Parimi i përgjegjësisë institucionale

1. Çdo projekt kërkimor i miratuar prej Komiteteve Shkencore të UV-së konsiderohet veprimtari institucionale dhe mbart përgjegjësi akademike dhe administrative.
2. Personeli akademik përgjigjet për:
 - Saktësinë shkencore të të dhënave;
 - Respektimin e standardeve etike;
 - Përdorimin korrekt të burimeve financiare dhe infrastrukture.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KREU II ORGANIZIMI DHE PËRBËRJA E KOMITETEVE SHKENCORE

Neni 6 Statusi dhe natyra juridike

1. Komiteti Shkencor i njësive kryesore është strukturë kolegjiale akademike në nivel fakulteti, me kompetencë vendimmarrëse për çështjet që lidhen me miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve kërkimore.
2. Komiteti Shkencor Institucional është strukturë *ad hoc*, në nivel universiteti, me kompetenca vendimmarrëse për projektet kërkimore në nivel universiteti dhe në rastet e apeliimeve të vendimmarrjes së Komiteteve Shkencore të njësive kryesore.
3. Komiteti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin, aktet e brendshme të universitetit dhe këtë Rregullorë.
4. Vendimet e Komitetit janë të detyrueshme për njësitë përkatëse akademike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga aktet me fuqi më të lartë juridike.

Neni 7 Përbërja e Komiteteve Shkencore

1. Komiteti Shkencor i njësive kryesore ka 3 (tre) anëtarë me të drejtë vote, me përbërje si më poshtë:
 - a) Drejtuesi i qendrës kërkimore-shkencore të njësive kryesore – kryetar
 - b) Personel akademik i kategorisë Profesor – 2 (dy) anëtarë
 - c) Sekretaria e Komitetit: Asistent Dekani (pa të drejtë vote).Anëtarët e Komiteteve Shkencore të fakulteteve nuk mund të jenë anëtarë të Komitetit Shkencor Institucional dhe të Komitetit të Etikës në Kërkim.
2. Komiteti Shkencor Institucional ka 5 (pesë) anëtarë me të drejtë vote, me përbërje si më poshtë:
 - a) Rektori i UV-së – kryetar
 - b) Personel akademik i kategorisë Profesor (kryesisht i fushës për të cilën kërkohet vendimmarrja) – 3 (tre) anëtarë
 - c) Drejtuesi / Specialist i Sektorit të Kërkimit Shkencor & Projekteve – 1 (një) anëtar
 - d) Sekretaria e Komitetit: Asistent Rektori (pa të drejtë vote).Anëtarët e Komitetit Shkencor Institucional nuk mund të jenë anëtarë të Komiteteve Shkencore të fakulteteve dhe të Komitetit të Etikës në Kërkim.
3. Në rast nevojë, Komitetet mund të ftojnë ekspertë të jashtëm me rol këshillimor, pa të drejtë vote.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Neni 8 Mandati

1. Komiteti Shkencor i njësisë kryesore ngrihet nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore pas përfundimit të zgjedhjeve të përgjithshme institucionale dhe funksionon deri në zgjedhjet institucionale të radhës.
2. Komiteti Shkencor Institucional ngrihet nga Rektori si komision ad hoc në rastet kur paraqitet nevoja për vendimarrje prej tij.
3. Në rast largimi para përfundimit të mandatit, zëvendësimi bëhet për periudhën e mbetur të mandatit.

Neni 9 Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit

1. Kryetari i Komitetit Shkencor drejton dhe koordinon veprimtarinë e Komitetit, duke garantuar funksionimin e rregullt, transparent dhe në përputhje me këtë Rregullore.
2. Kryetari ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Të thërrasë dhe të drejtojë mbledhjet e Komitetit;
 - b) Të përcaktojë rendin e ditës në përputhje me kërkesat dhe prioritetet institucionale;
 - c) Të caktojë oponentët për shqyrtimin e projekteve dhe raporteve përfundimtare;
 - d) Të sigurojë respektimin e procedurave, afateve dhe kriterëve të vlerësimit;
 - e) Të mbikëqyrë procesin e votimit dhe formalizimin e vendimeve;
 - f) Të përfaqësojë Komitetin në strukturat drejtuese të fakultetit dhe Rektorat, kur kërkohet;
 - g) Të sigurojë raportimin periodik mbi veprimtarinë e Komitetit;
 - h) Të garantojë respektimin e parimeve të paanshmërisë, konfidencialitetit dhe integritetit akademik.
3. Kryetari mban përgjegjësi për ligjshmërinë dhe rregullsinë procedurale të vendimarrjes së Komitetit.

Neni 10 Detyrat dhe përgjegjësitë e Anëtarëve

1. Anëtarët e Komitetit Shkencor ushtrojnë detyrën e tyre me përgjegjësi individuale dhe kolegjiale, në funksion të garantimit të cilësisë, paanshmërisë dhe integritetit të procesit të vlerësimit shkencor.
2. Anëtarët kanë detyrimin:
 - a) Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komitetit dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në diskutime;
 - b) Të shqyrtojnë me profesionalizëm dhe objektivitet projektet dhe raportet përfundimtare;
 - c) Të respektojnë kriteret e vlerësimit dhe afatet procedurale;
 - d) Të hartojnë vlerësime të argumentuara kur caktohen si raportues;
 - e) Të ruajnë konfidencialitetin e dokumentacionit dhe informacionit të trajtuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- f) Të deklarojnë çdo konflikt të mundshëm interesi përpara shqyrtimit të çështjes përkatëse;
- g) Të veprojnë në përputhje me standardet e etikës akademike dhe parimet e integritetit në kërkim.
3. Anëtarët mbajnë përgjegjësi për votën dhe qëndrimin e tyre në vendimmarrje, të reflektuar në procesverbal.
4. Mosrespektimi i detyrimeve të mësipërme përbën shkak për shqyrtim të mandatit nga organi kompetent, në përputhje me aktet institucionale në fuqi.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit

1. Sekretari i Komitetit Shkencor mbështet administrativisht dhe teknikisht veprimtarinë e Komitetit, duke garantuar dokumentimin, komunikimin dhe arkivimin korrekt të procedurave dhe vendimeve.
2. Sekretari ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për mbledhjet e Komitetit;
 - b) Të njoftojë anëtarët për mbledhjet dhe rendin e ditës brenda afateve të përcaktuara;
 - c) Të verifikojë plotësinë administrative të aplikimeve dhe raporteve përfundimtare;
 - d) Të mbajë procesverbalin e mbledhjeve dhe të sigurojë nënshkrimin e tij nga Kryetari;
 - e) Të regjistrojë dhe arkivojë vendimet, raportet dhe dokumentacionin përkatës;
 - f) Të komunikojë zyrtarisht vendimet e Komitetit me aplikantët dhe strukturat përkatëse;
 - g) Të ruajë konfidencialitetin e dokumentacionit të trajtuar;
 - h) Të përgatisë vendimet ose raportet administrative mbi veprimtarinë e Komitetit, sipas kërkesës së Kryetarit.
3. Sekretari nuk ka të drejtë vote në vendimmarrje, përveç rasteve kur është njëkohësisht anëtar me të drejtë vote sipas përbërjes së miratuar.
4. Sekretari mban përgjegjësi për saktësinë dhe integritetin e dokumentacionit administrativ të Komitetit Shkencor.

Neni 12

Vendimmarrja

1. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm.
2. Në rast se votimi nuk prodhon fitues, apo në rast se shumica e anëtarë të KSHF janë në konflikt interesi me projektin aplikues, vendimmarrja i delegohet KSHI.
3. Vendimet formalizohen me procesverbal dhe nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari.

Neni 13

Konflikti i interesit

1. Anëtari i Komitetit nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe votimin e një projekti nëse:
 - a) Është autor ose bashkëautor i projektit;
 - b) Ka lidhje financiare apo bashkëpunim të drejtpërdrejtë me aplikantin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- c) Ka interes personal apo institucional që cënon paanshmërinë.
2. Anëtari është i detyruar të deklarojë konfliktin e interesit përpara fillimit të shqyrtimit. Për çdo projekt aplikimi të vlerësuar, anëtarët e Komisionit janë të detyruar të nënshkruajnë Deklaratën e Konfliktit të Interesit, Paanshmërisë dhe Integritetit Profesional.
3. Konflikti i interesit pasqyrohet në procesverbal.

Neni 14

Shkarkimi dhe pezullimi

Anëtari mund të shkarkohet nga Dekani për KSHF dhe Rektori për KSHI, nëse:

1. Shkel dispozitat e kësaj Rregulloreje;
2. Shkel etikën akademike;
3. Mungon në më shumë se tre mbledhje radhazi pa arsye të justifikuar;
4. Gjendet në konflikt të përsëritur interesi.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KREU III KOMPETENCAT E KOMITETEVE SHKENCORE

Neni 15

Kompetencat e përgjithshme

Komiteti Shkencor i fakultetit është organi akademik përgjegjës për orientimin, koordinimin, vlerësimin dhe monitorimin e veprimtarisë kërkimore në nivel fakulteti, në përputhje me politikat dhe objektivat strategjike të universitetit.

Ai ushtron kompetencat e tij në funksion të garantimit të cilësisë shkencore, integritetit akademik dhe rritjes së performancës kërkimore.

Neni 16

Kompetencat për miratimin e projekteve

Komiteti Shkencor:

1. Shqyrton dhe vlerëson projekt-propozimet kërkimore;
2. Verifikon përputhshmërinë e tyre me prioritetet institucionale;
3. Vlerëson realizueshmërinë metodologjike dhe financiare;
4. Vendos për miratimin, rishikimin ose mosmiratimin e projektit;
5. Përcakton kushtet e realizimit, kur është e nevojshme.

Vendimi i Komitetit është i arsyetuar dhe i dokumentuar.

Neni 17

Kompetencat për vlerësimin e rezultateve

Komiteti Shkencor:

1. Kryen vlerësimin shkencor të raporteve përfundimtare;
2. Verifikon realizimin e objektivave dhe rezultateve të deklaruara;
3. Vlerëson prodhimin shkencor të gjeneruar nga projekti;
4. Jep miratim përfundimtar ose kërkon rishikim;
5. Rekomandon publikimin, shpërndarjen ose institucionalizimin e rezultateve.

Neni 18

Kompetencat në fushën e cilësisë dhe integritetit

Komiteti Shkencor:

1. Siguron respektimin e standardeve metodologjike dhe etike në kërkim;
2. Verifikon ekzistencën e miratimeve etike kur kërkohen;
3. Mund të kërkojë kontroll për plagjiaturë;
4. Referon çështjet që lidhen me shkelje etike pranë strukturave kompetente;
5. Propozon masa për përmirësimin e cilësisë kërkimore.

Neni 19

Kompetencat raportuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

1. Komiteti përgatit raport vjetor mbi veprimtarinë kërkimore në nivel fakulteti.
2. Raporti përfshin:
 - o Numrin e projekteve të miratuara;
 - o Gjendjen e zbatimit;
 - o Rezultatet e arritura;
 - o Analizë të performancës shkencore;
 - o Rekomandime për përmirësim.
3. Raporti bëhet pjesë e Raportit Vjetor të fakultetit dhe UV-së.

Neni 20

Kufijtë e kompetencës

1. Komiteti nuk ndërhyr në autonominë akademike individuale përtej rasteve kur kërkohet miratim institucional.
2. Komiteti nuk zëvendëson organet disiplinore apo financiare të universitetit, por bashkëpunon me to sipas kompetencave përkatëse.

Neni 21

Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të projekteve

1. Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të projekteve është e parashikuar në Rregulloren për projektet e kërkim-zhvillimit të financuara nga buxheti i UV-së.
2. Në rast të projekteve që nuk kërkojnë financim nga UV, por e kanë të nevojshme marrjen e Lejes së Zhvillimit dhe/ose Vlerësimin Shkencor (për përmbajtjen dhe cilësinë e rezultateve të projektit) tek njësitë kryesore apo institucioni, ndiqet e njëjta procedurë, sipas përcaktimeve në Rregulloren PKZHUV.

Neni 22

Konfidencialiteti

1. Dokumentacioni i projekteve trajtohet si konfidencial.
2. Anëtarët nuk mund të përdorin informacionin për qëllime personale ose konkurruese.

Neni 23

Arkivimi

1. Të gjitha aplikimet, raportet dhe vendimet arkivohen në mënyrë fizike dhe elektronike. Kopja elektronike i shkon Sektorit të Kërkimit shkencor & Projekteve dhe sekretarëve të KSHF dhe KSHI.
2. Dokumentacioni ruhet sipas rregullave të arkivimit institucional.

Neni 24

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe publikimit në faqen zyrtare të universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

2. Ajo zbatohet për të gjitha Komitetet Shkencore qw operojnw nw Universitetin 'Ismail Qemali'.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AURELA SALIAJ

ASel